



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:185402
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05711339

A-REV.nr.9/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Muhamet Rexha anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, A.Sh, rr. “P e F” nr. ..., P., kundër të paditurës Ministria e Financave Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve me seli në P., me bazë juridike anulim i aktit administrativ të organit të paditur, duke vendosur sipas revizionit të paraqitur nga paditësi, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.429/2023, të datës 25.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 15 Maj 2024, merr:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë si i palejuar revizioni i parashtruar nga paditësi, A.Sh., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.429/2023, të datës 25.03.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 2178/22, të datës, 16.05.2023, Refuzohet si e pa bazuar kërkesë padia e paditësit, kundër të paditurës Ministria e Financave Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, me të cilën ka kërkuar të anulohet Njoftimi i datës 11.08.2022, ti njohët e drejta në pension kontribut pagues të moshës nga dita e paraqitjes së kërkesës-dita e parë e aplikimit, duke e kompensuar në mënyrë retroaktive për muajt e humbur dhe atë, 20 muaj nga 165 Euro për muaj, 3.300€ gjithsej.

Duke vendosur në procedurë ankimore sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit si më lartë të shkallës së parë, Gjykata e Apelit-Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin, AA.nr.429/2023, të datës 25.03.2024, të kontestuar me revizion e refuzon si të pa bazuar ankesën e paditësit, A.Sh., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 2178/22, i datës, 16.05.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit si më lartë të Gjykatës së Apelit, paditësi në Gjykatë Supreme parashtron revizion, me të cilin e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj revizionin në atë mënyrë që aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë ti ndryshoj ose revizionin ta aprovoj dhe dhe aktgjykimet e sipër shënuar ti anuloj në tërësi si të pa bazë ligjore.

Gjykata Supreme shqyrtoi revizionin e ushtruar në pajtim me nenin 52.1, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe gjen se;

Revizioni është i palejuar.

Sipas Nenit 24, të Ligjit për Konfliktet Administrative, (LKA), parashihet se, *kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrorë në Gjykatë Supreme, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrorë vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale, ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishin ndikim në zgjidhjen e çështjes.*

Sipas Nenit 25 të LKA, parashihet se, *kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës, prokurori publik mund t'i parashtrorë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse me vendim të tillë është shkelur ligji, dispozitat e tjera ose akti i përgjithshëm.*

Sipas nenit 50, parag.1, të LKA, parashihet, ” *kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën. Sipas parag.2, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitet brenda nëntëdhjetë (90), ditëve nga dita kur u është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa”.*

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe dispozitave të cituara të Ligjit për Konflikte Administrative kjo gjykatë gjen se, kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrorë në Gjykatë Supreme, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa Prokurori Publik, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Nga theksimet si më lartë rezulton se, me revizion nuk mund të kontestohen vendimet e formës së prerë të Departamentit për Çështje Administrative të gjykatës së shkallës së dytë, prandaj kjo gjykatë e hedhë poshtë revizionin e paditësit si të palejuar.

Nga parashtrimet si më lartë dhe në kuptim të nenit 52.1, lidhur me nenin 24 dhe 25, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME- PRISHTINË
A. REV. nr. 9/2024, datë 15 Maj 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani